

VENDIM
Nr.119, datë 25.2.2005

PËR KRIJIMIN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Dibrës, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:

2.1 Zona e fushës së Dibrës, në Fushë Aliaj-Kastriot-Maqellarë-Arras-Zall-Dardhë, që kullon një sipërfaqe prej 1500 ha;

2.2 Zona e fushës së Matit, që kullon një sipërfaqe prej 1200 ha;

2.3 Zona e fushës në Bulqizë, në Gjoricë, që kullon një sipërfaqe prej 600 ha;

2.4 Zona e fushës së Bulqizës, që kullon një sipërfaqe prej 200 ha;

2.5 Pendet mbrojtëse nga përmytja e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;

2.6 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, që janë brenda fushave të sistemuara.

3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:

a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;

d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;

dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.

4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje, me 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano